



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Ministarstva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju

Ministry of Education, Science and Technology



UDHËTIMI nëpër *internet*

Udhëzues për nxënës/fëmijë
të klasave 3-5 të arsimit fillor



UDHËTIMI NËPËR INTERNET

*Udhëzues për nxënës/fëmijë të klasave
3-5 të arsimit fillor*

Autoret: Mimoza Hasani Pllana & Merita Januzi

Redaktore: Shqipe Z. Gashi

Lektore: Afërdita Kryeziu

Kontribuesit:

Alush Istogu

Faton Fetahu

Avni Rexha

Veton Alihajdari

Teuta Zymeri

Habibe Buzuku

Edi Puka

Shkëndije Nagavci

Shpresa Shala

Minire Gashi

Bislim Krasniqi

Dizajni dhe faqosja: Diellor Gashi (e-mail: gashidiellor@gmail.com)

Shtypi: Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

Botues: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT)

Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MASHT dhe autorëve

ISBN 978-9951-19-081-7

Përmbajtja

1. INTERNETI	6
2. PSE UDHËTOJMË DHE SI?	10
2.1. Mësimi	11
2.2. Kërkimi i informacionit	12
2.3. Komunikimi	13
2.4. Shoqërimi (rrjetet sociale)	13
2.5. Argëtimi	14
3. TË ECIM ME KUJDES!	15
3.1. Rregulla e parë: <i>Mos komuniko me persona të panjohur në internet!</i>	16
3.2. Rregulla e dytë: <i>Mos i ndaj fjalëkalimet me miqtë apo personat tjerë!</i>	17
3.3. Rregulla e tretë <i>Mos kliko mbi reklamën që të shfaqen në ekran apo mbi faqet që nuk i ke kërkuar!</i>	22
3.4. Rregulla e katërt: <i>Mendo para se të veprosh!</i>	24
3.5. Rregulla e pestë: <i>Kujdes nga përdorimi i lojërave online!</i>	25
4. ARRITJA	27
Përfundim	28



1. INTERNETI

I dashur nxënës (fëmijë),

Në kohën të cilën po jetojmë të gjithë po e përdorim internetin si në familje, ashtu edhe në shkollë e vend të punës. Po ashtu edhe në hapësira tjera si në rrugë, restorane, etj., njerëzit e kanë mundësinë e përdorimit të internetit, ngase tani atë e kemi kudo.

Interneti u zbulua nga amerikanët në vitin 1960. Pastaj, nga viti në vit u zgjerua përdorimi i tij, aq sa në ditët e sotme gati të gjithë njerëzit e shfrytëzojnë atë në mënyra të ndryshme.

Përmes internetit mund të udhëtosh kudo që ti dëshiron. Ju tashmë e dini se udhëtimin e bëni përmes kompjuterit, tabletëve dhe pajisjeve tjera elektronike, të cilat janë makineri të zgjuara që mendojnë shpejt. Këto makineri nuk punojnë vetë, ato bëjnë çfarë t`u thuash, ato përgjigjen në atë çfarë ti u kërkon dhe të dërgojnë në vendet ku ju doni të udhëtoni.

Përmes internetit mund të bëhesh pjesë e një bote magjike, ku ka hapësirë të mjaftueshme për çdo gjë që të pëlqen.

Përmes tij mund të udhëtosh në kontinente të ndryshme si, në kontinentin e

lojërave, në kontinentin e filmave e të videove të ndryshme për fëmijë. Pastaj, mund të udhëtosh në kontinentin që të ofron komunikimin me miqtë dhe familjarët. Por, gjithashtu, mund të zbulosh edhe kontinente të reja të pazbuluara deri tani.

Pasi të jesh lidhur në internet, mund të hysh në një shumëllojshmëri aktivitete të quajtura "Shërbimet e internetit". Disa prej tyre po i listojmë më poshtë:

Shfletimi i faqeve të internetit (anglisht: webBrowsing) bëhet duke përdorë programet, si: Internet Explorer, Safari, Firefox, Opera, Google Chrome e të ngjashme, në të cilat mund të gjeni tekst, fotografi, muzikë, video, lojëra etj.



Google

Mbaj mend!

➔ **Google** është motor kërkimi ku mund të gjeësh informata të ndryshme në shumë gjuhë të botës, por edhe fotografi, video, harta, filma etj.

Google të jepë përgjigje të shpejta!

Jo të gjitha informatat mund të jenë të sakta!

Kujdes!

Mos kliko mbi informatat që nuk i ke kërkuar!

SAFE SEARCH KIDS

The kid friendly search engine

Google™ Custom Search

Make Safe Search your Home Page*

[Learn More*](#)



Mbaj mend! 🐼

➔ Kjo nuk është Google. Kjo është gjithashtu një motor kërkimi që përdoret ashtu si edhe Google, por që mundëson bllokimin e materialeve që mund të jenë të dëmshme për fëmijët.

Gjatë udhëtimit nëpër internet përdor motorët e kërkimit si Safe search kids ose Ask Kids, Yahoo Kids, KidRex meqë ato nuk përmbajnë informata të dëmshme për fëmijë dhe të bëjnë të ndihesh i sigurt gjatë udhëtimit!



Në
YouTube kids
mund të shikosh videot
tua të preferuara muzikore,
filmike, si dhe programe
edukativo-arsimore,
familjare etj!
YouTube mund të përmbajë
video të papërshtatshme
për fëmijët!

Mbaj mend! 🧠

➔ Youtube kids është aplikacion (app) i krijuar për fëmijët, që ka për qëllim shfaqjen e videove të përshtatshme për moshat e reja, përdorimin e gjuhës miqësore dhe mbrojtjen e fëmijëve nga fjalët dhe pamjet e papërshtatshme, të cilat mund të shfaqen në Youtube. Youtube kids mund të shkarkohet në Android dhe iOS.



Mbaj mend! 🧠

➔ Loja Minecraft është një lojë tërheqëse që u krijua në vitin 2009 nga programeri suedez Markus Persson, e cila të jepë mundësinë që të krijosh çdo gjë në bazë të imagjinatës, duke filluar nga një shtëpi e vogël, nga një shkollë e deri te fshatra apo qytete të mëdha.

Përmes Minecraft education dhe lojërave tjera edukative mund t'i japësh formë imagjinatës tënde, duke krijuar shumë gjëra të bukura dhe edukative!



Mbaj mend! 🧠

➔ E-mail të ofron mundësi komunikimi me të tjerë duke u dërguar mesazhe, fotografi, video etj. Emailin e hapni me fjalëkalim, për rëndësinë e të cilit do të njoftoheni më poshtë përgjatë mësimeve të këtij libri.

Askujt mos i dërgo mesazhe fyese!
Por, edhe tekstet e gatshme, fotot, etj., mos i përdor në dëm të askujt!



Mbaj mend! 🧠

➔ Chat-i të ofron mundësi të komunikimit me personat që janë online dhe mund të zhvillohet një lloj bisede e drejtpërdrejtë me një person apo me një grup personash tjerë.

Në chat duhet të bisedosh vetëm me personat e njohur dhe vetëm me dijen dhe nën kujdesin e prindërve!



Forumet janë vendet/ hapësirat ku njerëzit vendosin informata, mesazhe dhe mendimet e tyre për tema të caktuara. Kur të rritesh do të kesh mundësi të marrësh pjesë në forume duke treguar interesimet dhe njohuritë tua në tema e fusha të ndryshme.

Si përfundim, i dashur fëmijë/ nxënës, po e përsërisim edhe njëherë se, në internet mund të zhvillosh një mori aktivitete. Mirëpo, gjithmonë duhet pasur parasysh se internetin e përdorin shumë njerëz anë e kënd botës dhe për arsye të ndryshme. Disa atë e përdorin për qëllime të mira, kurse të tjerët e përdorin për qëllime të këqija. Prandaj, duhet të jesh i kujdesshëm dhe të udhëtosh i sigurt në internet. Gjithashtu, duhet të mësosh ta përdorësh kompjuterin, por edhe duhet të vendosësh rregulla se sa gjatë brenda ditës do ta përdorësh atë.

● **N**e duam që përmes këtij libri të të mësojmë se si të kujdesesh gjatë përdorimit të internetit, për t'u larguar nga rreziqet e shumta, çfarëdo qofshin ato. Ti do të luash e do të angazhohesh dhe nëpërmes lojës e detyrave argëtuese do ta kuptosh se si duhet mbrojtur gjatë përdorimit të internetit.

2. PSE UDHËTOJMË DHE SI?

Mbaj mend! 🧠

➔ Çdo udhëtim ka një qëllim. Edhe udhëtimi në internet bëhet për disa qëllime.

Qëllimet mund të jenë:

- mësimi;
- kërkimi i informacionit;
- shoqërimi (rrjetet sociale);
- komunikimi;
- argëtimi etj.



Po ti, përse e përdor internetin?

Unë e përdor internetin për: _____

Trego, përse e përdorin internetin anëtarët e familjes suaj!

Kohëzgjatja: 30 minuta



2.1. Mësimi

Duke shëtitur nëpër internetin me plot mundësi, mund të mësosh gjithçka. Nëse të duhet një informatë për një mësim që e ke mësuar në shkollë, ti mund të hysh në Google dhe ta shënosh temën që të intereson. Atëherë, në internet do të dalin faqe me informata të shumta të cilat mund të ndihmojnë shumë në mësim. Mund të gjeësh edhe fotografi e ilustrime të cilat ofrojnë pamje më të qarta se si duken gjërat për të cilat keni dikshtuar me mësuesin / mësuesen tënde.

Mbaj mend! 🧠

➔ Nga interneti mund të mësoni gjëra të reja që nuk i keni lexuar në librat shkollorë. Ato ju ndihmojnë të bëheni më të ditur dhe dituria ua hap dyert e lumturisë.

Aktiviteti Aktiviteti

1

Uluni bashkë me shokun/shoqen tuaj para kompjuterit dhe kërkoni në Google, p.sh:
Si ushqehet kafsha që ju pëlqen?

Pasi të keni hapur faqet me informatat e nevojshme, regjistroni ato kryesoret dhe kërkoni edhe për llojet e kafshëve!



Mbaj shënime!

Kafsha që më pëlqen është.....
Ajo ushqehet me.....
Llojet e kafshëve.....

Kohëzgjatja: 30 minuta

2.2. Kërkimi i informacionit

Nganjëherë të duhet një informatë e shpejtë dhe pikërisht atë mund ta gjesh në internet. P.sh. të intereson: sa km, apo sa banorë i ka vendi ynë Kosova? Kush e shkroi librin “Princesha Argjiro” etj. Këto mund t'i gjesh menjëherë në Google. Njëjtë mund ta kërkosh çfarëdo informate që të duhet nga fusha të ndryshme. Dhe, përveç në Google, informacione mund të kërkosh edhe në Yahoo dhe në Bing. Ne të sugjerojmë që sa më shumë t'i përdorësh motorët e kërkimit që janë për fëmijë.



Mbaj mend! 🐼



Shfrytëzoje kohën e duhur për informatat që të nevojiten dhe kujdesu që mos të rrish gjatë para kompjuterit!
Qëndrimi i gjatë para kompjuterit e dëmton shëndetin, prandaj kalo më shumë kohë duke luajtur në natyrë!

Aktiviteti

2


Kërko në internet emrin e sportistit/sportistes që e pëlqeni! Pasi ta gjesh informatën, shëno emrin, ditëlindjen, vendlindjen dhe çfarëdo që të ka bërë përshtypje!

Diskuto me shokë e shoqe të arriturat e sportistit/sportistes së njohur!



Mbaj shënime!

Kohëzgjatja: 30 minuta



2.3. Shoqërimi (rrjetet sociale)

Rrjetet sociale nuk janë të përshtatshme për moshat e reja. Aty ka mundësi shoqërimi me familjarë e shoqëri pa fund, por edhe rreziqet janë të mëdha. Prandaj, duhet ta arrini moshën e duhur për të udhëtuar në rrjetet që i ofron interneti. Mirëpo, nëse tashmë ke hyrë brenda tyre, lexo dhe ndiqi rregullat e sigurisë në internet!

2.4. Komunikimi

Nëpërmjet internetit (E-mail, Chat, Skype) mund të komunikosh me familjarët, shokët e klasës e miqtë tjerë, për të shkëmbyer informatat që të duhen rreth familjes, mësimëve, shoqërisë. Komunikimi i mirë të ndihmon të jesh i/e sjellshëm/e dhe i/e dashur me familjarët dhe shokët e tu, si dhe ata të jenë me ty. Ndonëse je në moshë të vogël për përdorim të e-mailit, duhet ta dish që tani se komunikimi mund të ndikojë mirë apo keq në marrëdhiet tua me të tjerët.

Mbaj mend! 🧠

➡️ Komunikimi i mirë është sjellje e shëndoshë! Mos fol keq me asnjërin! Mos i dërgo askujt mesazhe fyese! Komunikimi i keq sjell dhunën!

Aktiviteti

3

Luani në role dialogun mes dy shokëve të klasës Rronit dhe Erës, në lidhje me detyrat e shtëpisë! Trego si reagon Rroni kur i flet mirë dhe si reagon Era kur i flet keq!



Mbaj shënime!

Si reagoi Rroni?

Si reagoi Era?

Kohëzgjatja: 30 minuta

2.5. Argëtimi

Argëtimi nëpërmjet lojërave është me interes për zhvillimin tënd të shëndetshëm. Interneti përmban lojëra shumë të mira edukative që të mësojnë si të sillësh. Ato të fusin në botën e bukur përrallore dhe të bëjnë të shkathët në shumë drejtime.

Mosha jote duhet të përmbushet me lojë e argëtim, gjatë kohës që e caktoni bashkë me prindërit.

Loja e argëtimi duhet të të shkarkojnë nga lodhja e shkaktuar nga mësimet edhe detyrat e përditshme. Pastaj, pas një pushimi të arsyeshëm (gjumë, ndejë) fiton energji të reja për mësimet e mëtutjeshme në shkollë e shtëpi.



Mbaj mend! 🧠



Shfrytëzoje kohën e duhur për lojë!

Mos e tepro me lojën, duke lënë anash detyrat dhe librat shkollorë

Aktiviteti **Aktiviteti**

4

Kërko në internet lojën Minecraft education. Atë mund ta shkarkosh në kompjuter, tablet, telefon etj. dhe pastaj mund të luash dhe të krijosh çkado që të pëlqen ty (liqe, fshat, objekt shkollor, shtëpi etj.). Njësoj mund të kërkosh edhe lojëra tjera edukative.



Mbaj shënime!

Çka krijove dhe si u ndjeve në fund?

Çka do të bëhesh kur të rritesh?

Kohëzgjatja: 30 minuta

3. ECIM ME KUJDES

Gjërat që duhet të dish para udhëtimit në internet

Sikur para çdo udhëtimi tjetër, edhe para udhëtimit në internet duhet të kesh parasysh disa rregulla, të cilat do të mbrojnë gjatë gjithë udhëtimit, duke të bërë fëmijë të zgjuar në përdorimin e internetit.



Pesë rregulla të rëndësishme për sigurinë në internet:

- 1** Mos komuniko me persona të panjohur në internet!
Për cdo shqetësim bisedo me prindërit apo mësuesin/mësuesen!
- 2** Mos i ndaj fjalëkalimet me miqtë apo personat tjerë!
- 3** Mos kliko mbi reklamën që shfaqen në ekran!
- 4** Mendo para se të veprosh!
- 5** Kujdes nga rreziqet tjera në lojërat online!



3.1. Rregulla e parë



Mos komuniko me persona të panjohur në internet!


Kur fillon ta përdorësh internetin, mos mbaj sekrete me prindërit për gjërat që dëshiron t'i dish, apo për gjërat që mund të të shqetësojnë. Bisedo me prindërit apo mësuesin/mësuesen para çdo udhëtimi në internet, qofshin ato lojëra online, kërkime në motorët e kërkimit, krijim i adresës elektronike, komunikim në chat, në klane dhe në forume apo edhe programe tjera.



Mbaj mend! 🧡



Mos komuniko me persona të panjohur në internet! Jo të gjithë njerëzit e përdorin internetin për qëllime të mira! Për çdo shqetësim bisedo me prindërit apo mësuesin/mësuesen! Gjatë komunikimit në internet publiko sa më pak detaje që të identifikojnë ty apo vendndodhjen tënde



Tregim: “Lumi, shoku i ri nga interneti”

Lea ishte një vajzë e zgjuar, e bukur dhe mbi të gjitha shumë e talentuar. Ajo ishte e dalluar në mësimet dhe në aktivitete të shkollës. Ajo ishte vajzë e hapur dhe komunikative me rrethin familjar dhe shoqëror. Njësoj ishte komunikative edhe kur përdorte internetin, madje edhe me persona të panjohur.

Një ditë, Lea nuk kishte marrë notën më të mirë në mësimet dhe u mërzi shumë. Sapo arriti në shtëpi, u mbyll në dhomën e saj, pa dashur të flasë me prindërit lidhur me atë që i kishte ndodhur. Menjëherë ndezi kompjuterin dhe filloi të komunikojë me bashkëmoshatarin e saj të panjohur, shokun e ri nga interneti - Lumin.

Sa mirë që po të shoh online Lumi. Dua të flas me dikë, por jo me babin e mamën! - i tha ajo gati duke qarë.

Pse, çka ka ndodhur? - e pyeti Lumi.

Ajo nisi të rrëfej se si kaloi me mësimet në shkollë. Ndërkohë Lumi e pyeti: Në cilën shkollë shkon, në cilën klasë dhe ku banon?

Ajo, e gëzuar që i foli Lumi, i përgjigjet atij në të gjitha pyetjet me saktësi. Madje i tregon edhe për angazhimet që ajo i kishte pas mësimet. Lumi e përgëzon për të gjitha dhe kërkon të dijë më shumë për aktivitetet që i pëlqenin asaj dhe të cilat i ndiqte. Lea i tregon të gjitha dhe e fton në ushtrimet e baletit, të cilat i mbante çdo të hënë nga ora 18:00 deri në ora 19:00. Lumi e falenderon për këtë dhe kalon offline.

Të hënë Lumi nuk shkon në ushtrimet e baletit, por e pret Lean në lagjen e saj, në kohën kur ajo po kthehej në shtëpi. Me të arritur afër shtëpisë, dikush nga prapa ia kap dorën dhe e tërheq afër vetes. Lea e trishtuar pyet: “Kush jeni ju?” Burri i moshuar qetësisht i thotë: “Jam Lumi, shoku i internetit”. Lea fillon të bërtasë me sa zë që kishte, por Lumi i kërkon të qetësohet, duke e siguruar se nuk do t’i ndodhë asgjë e keqe.

Lumi, burri i moshuar me të cilin Lea ditë më parë kishte ndarë shumë informata, kërkon të takojë prindërit e saj për t’i treguar atyre se çfarë u kishte ngjarë. Gjatë bisedës me të tre, Lumi u sqaron atyre se ai shtret si fëmijë në komunikimet online, me qëllim të vetëdijësimit të fëmijëve, për t’u treguar atyre se komunikimi me të panjohur është shumë i rrezikshëm. Pas këtij momenti Lea u premtoi prindërve se kurrë më nuk do ta përsërit gabimin që të komunikojë dhe t’i ndajë informatat me të panjohur në internet.

Aktiviteti **Aktiviteti**

5

Diskuto në grup për rreziqet që mund të shfaqen nga komunikimi me të panjohur.
Shëno me v veprimet që duhet t'i bësh dhe me **X** veprimet që nuk duhet t'i bësh në internet.

Komuniko me të panjohur!



Trego adresën e shtëpisë tënde gjatë komunikimit!



Diskuto me prindërit apo mësuesin/mësuesen për shqetësimet!



Trego të dhënat e prindërve tuaj (numrin e telefonit, kartelën bankare, vendin e punës)!



Përdor gjuhë miqësore!



Fyej shokun ose shoqen!



Publiko fotografitë e shokut ose shoqes pa lejen e saj/tij!



Mos fto të panjohur në shtëpi ose lagje!





Mos cakto takime me të panjohur!




 *Trego vendndodhjen tënde!*




 *Trego klasën, shkollën apo vendbanimin!*




 *Komuniko vetëm me shokët, familjarët apo personat që i njeh!*



 *Mos diskuto për gjendjen tënde emocionale me miqtë nga internet!*



 *Diskuto për programin e shkollës dhe programet tjera me miqtë nga interneti!*




3.2. Rregulla e dytë

Mos i ndaj fjalëkalimet me miqtë apo personat tjerë!

Kur fillon ta përdorësh internetin, mos mbaj sekrete me prindërit për gjërat që dëshiron t'i dish, apo për gjërat që mund të të shqetësojnë. Bisedo me prindërit apo mësuesin / mësuesen para çdo udhëtimi në internet, qofshin ato lojëra online, kërkime në motorët e kërkimit, krijim i adresës elektornike, komunikim në chat, në klane dhe në forume apo edhe programe tjera.



Mbaj mend! 

 Fjalëkalimi në internet është sikur qelësi në shtëpi, me të hap derën e shtëpisë tënde në internet!

Fjalëkalimin duhet ta ruash me kujdes!

Aktiviteti Aktiviteti

6

Fjalëkalimi është çelësi i pajisjes suaj elektronike (e-mailit dhe llogarive tjera në internet). Ai është i rëndësishëm për sigurinë e gjërave tua personale, po aq sa është i rëndësishëm çelësi i shtëpisë për ruajtjen e gjërave tua brenda saj.

Paramendo, sikur çelësin e shtëpisë t'ia jepni një të panjohuri në rrugë.



- Çfarë mund të ndodhë në këtë rast? Shkruaj ose paraqit përmes vizatimit rreziqet që mund të ndodhin dhe si do të ndiheshe nëse i panjohuri do të hynte në shtëpinë tënde!





- Çfarë mund të ndodhë nëse fjalëkalimin ua tregon personave tjerë? Shkruaj ose paraqit përmes vizatimit rreziqet që mund të ndodhnin dhe si do të ndiheshe nëse i panjohuri hyn në pajisjen tënde elektronike (në e-mail apo llogaritë tjera).



A large, empty rectangular box with a light gray border, intended for drawing or illustrating the risks mentioned in the text.

3.3. Rregulla e tretë



Mos kliko mbi reklamat që të shfaqen në ekran apo mbi faqet që nuk i ke kërkuar!

Mbaj mend! 🐼

➔ Klikimi mbi reklamat (pup-ups) në ekran mund të bllokojë pajisjen tënde elektronike! Klikimi mbi faqet që nuk i ke kërkuar ta humbë rrugën për udhëtim në internet!

Aktiviteti Aktiviteti

7

Sapo e ndez pajisjen tënde elektronike dhe kyqesh në internet, mund të shfaqen përmbajtje (reklama) në ekran, që ju ftojnë në vende të ndryshme, madje edhe në ato vende që nuk i ke vizituar më parë. Duhet të kesh kujdes që të mos klikosh mbi ato, por të vazhdosh kërkimin e mësimin, lojës apo filmit të dëshiruar. Po ashtu duhet të mos klikosh mbi faqe tjera, të cilat nuk përputhen me qëllimin tënd të kërkimit. Klikimi mbi faqe tjera të shpie në klikime pa fund dhe mund të të bëjë që ta humbasësh rrugën e udhëtimit në internet. P.sh.: Interesimi yt është të gesh më shumë informata për bari (gjelbërim), ngase don t'i ndihmosh prindërit për rregullimin e kopshtit. Por, kur hyn dhe kërkon në Google fjalën “bari”, të dalin faqe që mund të lidhen edhe me fjalën “bari” (ruajtës i bagëtisë). Kështu, këto fjalë (homonime) apo nganjëherë edhe vetëm një rrokje të lidhin me faqe tjera që nuk të duhen.



Shiko shembullin në aktivitetin më sipër dhe në hapësirën nr.1. Vizato skemën se si mund të arrish deri në vendin e kërkuar, pa klikuar mbi faqet tjera. Ndërkaq, në hapësirën nr. 2. Vizato skemën se si mund ta humbasësh rrugën, duke klikuar mbi faqe që nuk i ke kërkuar



3.4. Rregulla e katërt

Mendo, para se të veprosh!

Mbaj mend! 🧠

- ➔ Mendo, para se të publikosh!
 Diçka që njëherë e publikon në internet gjithmonë mbetet në internet.
 Përdor gjuhë miqësore në komunikim!
 Mos mbaj kompjuter apo pajisje elektornike në dhomën e gjumit!

Aktiviteti **Aktiviteti**

8

Shih ilustrimin në të cilin paraqitet situata e një veprimi të pamenduar në internet dhe diskuto në klasë apo familje për pasojat që mund të ndodhin nga veprimet e tilla.

**Mbaj shënime!**

Kohëzgjatja: 30 minuta

3.5.Rregulla e pestë:



Kujdes nga përdorimi i lojërave online!

Mbaj mend! 🐼



Kërko dhe luaj bashkë me prindërit!
Koha maksimale e lojërave në internet për fëmijët e moshës 7-10 vjeç nuk duhet të jetë më shumë se 1 orë!
Luaj në lojërat e dizajnuara për moshën tënde!



Aktiviteti **Aktiviteti**

9

Fto shokun ose shoqen tënde për një lojë online të përbashkët me prindërit!

Së bashku me prindërit kërko lojërat online që ofrojnë mundësinë të luani në grup. Shkarko ato dhe luaj së bashku me anëtarët e familjes apo shokët/shoqet e klasës. Kështu, do të krijosh një skuadër të fortë, të gatshme për gara me skuadrat e familjeve të shokëve tu.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Përmes rrumbullakësimit të shenjave trego si ndihesh kur luan vetëm dhe si ndihesh kur luan në grup!

Kur luan vetëm :



Kur luan në grup:



Kur të arrini moshën e duhur, në bashkëpunim me prindërit do të bëheni pjesë edhe e rrjeteve sociale.



Mbaj mend! 🤔



Respektimi i rregullave të bën të sjellshëm, të zgjuar dhe të mbron gjatë gjithë udhëtimit në internet.

Aktiviteti Aktiviteti

10

Kërko në Youtube kids video që kanë temë:

Mbrojtjen e fëmijëve në internet. P.sh. mund të gesh përrallën me Kësulëkuqen në disa episode (pjesë), të cilat të mësojnë se si të mbrohesh në internet. Nëse përrallën e gjeni vetëm në gjuhën anleze (Little Red Riding Hood), kërkon ndihmë nga mësuesi/mësuesja ose prindërit. Shikoi ato bashkë me shokët e klasës apo me prindërit dhe bisedoni rreth asaj që mësuat nga kjo përrallë! Njësoj mund të kërkon video edhe me përralla tjera për qëndrimin e sigurt në internet (internet safety).



Shkruaj ose vizato se çfarë mësove nga viedot për përdorimin e internetit në mënyrë të sigurtë?






Kohëzgjatja: 30 min.

4. ARRITJA

Duke e përdorë mirë internetin për mësim, lojë, informim dhe komunikim, pa e keqpërdorë atë në asnjë formë që mund t'i shkaktonte problem a dëm dikujt, do të arrish aty ku duan të të shohin më të dashurit tuaj: prindërit, familja, mësuesit dhe shoqëria.

Në këtë moshë shkollore do të arrish rezultate të mira në mësim, do të fitosh shkathtësi në të shprehur, do të bëhesh krijues (kreativ), do të njihesh me botën që të rrethon dhe brenda saj do të sillësh me dobi. Kështu, do të rritesh shëndetshëm dhe përfundimisht do të sillësh përgjegjshëm kudo, si në: familje, shkollë e shoqëri.

Luani si në teatër, duke ndarë rolet:



- *Dëbora dhe Drini, të cilët janë motër e vëlla.*
- *Dëbora respekton këshillat e mësueses dhe të prindërve për përdorim të internetit.*
- *Drini e tepron dhe i ka lënë anash librat, duke qëndruar pa kontrollë në internet.*
- *Paraqitni me anë të lojës teatrale rezultatet e të dy personazhëve tuaj (Dëbora e Drini)!*
- *(Për një shfaqje ju duhet t'i ndani disa role, si: Dëbora, Drini, mësuesi, nëna, babai.*
Ju jeni të lirë ta imagjinoni/ luaji lojën, por me ndihmën e mësuesit/mësueses).

- Qëllimi i lojës është që të kuptoni rrugën e drejtë dhe atë të gabuar.
- Duhet ta kuptosh qart ku të çojnë gabimet dhe ku përdorimi i duhur i internetit.
- Bisedo për këto gjëra me prindin dhe mësuesin/mësuesen tuaj!

Diskutoni në klasë se si jeni ndjerë gjatë aktrimit! Secili le ta tregojë përjetimin e vet sipas rolit që kishte.





Përfundim

- *I dashur fëmijë (nxënës), besojmë se të kemi ndihmuar me këtë libër të vogël.*
 - *Shfrytëzoje këtë libër dhe ndiqi udhëzimet tona, të cilat mund të plotësohen edhe nga mësuesit dhe prindërit tuaj!*
-

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

004:37(075.2)(035)

Udhëtim nëpër internet: udhëzues për nxënës/fëmijë të klasave 3-5 të arsimit fillor / MASHT. – Prishtinë: MASHT, 2016. – 28 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

ISBN 978-9951-19-081-7



UDHËTIMI

nëpër

internet

UDHËZUES PËR NXËNËS/FËMIJË TË KLASAVE 3-5 TË ARSIMIT FILLOR

ISBN 978-9951-19-081-7



9 789951 190817